



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr.240 i Vendimit

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Irir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 27.07.2020 mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Aleksandër Kito, etj.

I PADITUR: Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I. Rrethanat e Çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar pagimin e dëmshpërblimit pasuror dhe jopasuror për dëmtimin e shëndetit të fëmijës Aleksandër Kito.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, ka vendosur:

“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësve Aleksandër Kito, Aristotel Kito, Juliana Memaj, Vasil Kito, Flamur Memaj, Eli Memaj, Orsiol Memaj dhe Dorina Memaj.

Detyrimin e palës së paditur Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” të dëmshpërblejë paditësit Aleksandër Kito, Aristotel Kito, Juliana Memaj, Vasil Kito, Flamur Memaj, Eli Memaj, Orsiol Memaj dhe Dorina Memaj për dëmin pasuror dhe jopasuror, të shkaktuar nga dëmtimi i shëndetit të fëmijës Aleksandro Kito gjatë lindjes së tij me datë 26.01.2012, si vijon:

1. *Paditësi Aleksandros Kito të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëmin pasuror në vlerën 3.856.298 lekë.*
 - *Dëmin jopasuror: dëm biologjik në vlerën 3.856.298 lekë; dëm moral në vlerën 1.928.149 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 1.928.149.*
2. *Paditësi Aristotel Kito të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm jopasuror: dëm moral në vlerën 1.928.149 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 1.928.149 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzimet spitalore në vlerën 1.478..452 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzime për përkujdesje në vlerën 10.032.000 lekë, shpenzime për këshillime psikologjike në vlerën 4.680.000 lekë, shpenzime për fizioterapi në vlerën 41.610.000 lekë dhe shpenzime për pajisje ortopedike në vlerën 5.520.000 lekë.*
3. *Paditësja Juliana Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm jopasuror: dëm moral në vlerën 1.928.149 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 1.928.149 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzimet spitalore në vlerën 1.478..452 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzime për përkujdesje në vlerën 10.032.000 lekë, shpenzime për këshillime psikologjike në vlerën 4.680.000 lekë, shpenzime për fizioterapi në vlerën 41.610.000 lekë dhe shpenzime për pajisje ortopedike në vlerën 5.520.000 lekë.*
4. *Paditësi Vasil Kito të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 964.074 lekë.*
5. *Paditësja Eli Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 964.074 lekë.*
6. *Paditësi Flamur Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 964.074 lekë.*
7. *Paditësja Orsiola Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë.*
8. *Paditësja Doriana Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë.*

Rrëzimin për pjesën tjetër të kërtimeve si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Shpenzimet gjyqësore dhe ato për vënien në ekzekutim të vendimit në ngarkim të palëve në masën 1/3 paditësit dhe 2/3 pala e paditur.”.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 2859 (80-2016-2987), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.

4. **Kundër vendimit nr. 2590, datë 02.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

5. **Pala e paditur, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”**, në datën 13.07.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Kërkimin tonë e motivojmë me drejtësinë dhe bazueshmërinë në prova e në ligj të vendimeve të të dyja gjykatave të faktit, të cilat Gjykata e Lartë ka mundësinë t'i konstatojë gjatë gjykimit të saj dhe ku haptazi ekziston mundësia që kjo vendimmarrje të ndryshojë.*
- *Nga ana e kësaj Gjykate është dhënë një vendim me të njëjtin shkak me një spital tjetër si QSUT “Nënë Tereza”.*
- *Praj 11 marsit të 2020 “Shpallja e pandemisë botërore”, ndikoi më së shumti në financat jo vetë të buxhetit të shtetit por edhe të buxhetit të Spitalit në vend, i cili duhet të jetë në gadishmëri të plotë për të përballuar situatën pandemike, duke rritur shpenzimet në sigurimin e medikamenteve, materialeve të mjekimit, krijimin e ambienteve të përshtatshme infrastrukturore për të akomoduar pacient me Covid-19.*
- *Për shkak të Covid-19 situata financiare është kritike dhe buxheti i spitalit nuk mund të përballojë pagimin e detyrimit, pasi do të ndikonte rëndë në cilësinë e shërbimit shëndetësor ndaj të gjithë pacienteve, për shkak të një vlere tepër të lartë dhe të paimagjinueshme për një vend si Shqipëria.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i këtij vendimi do të sillte dëme serioze dhe të riparueshme e pasoja të rënda, duke rrezikuar e cënuar seriozisht funksionimin e shërbimit në Spital dhe për rrezikimin e jetëve të njerëzve për shkak të mungesës së medikamenteve përkatëse për kurimin e tyre.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të

pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

14. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

15. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, por Kolegj çmoi të vijoj sipas përcaktimi të pikës 4 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon se:

“.....4.Në kushtet kur rrethanat e çështjes e diktojnë dhe ekziston rreziku se e drejta e rekursuesit do të bëhet e pamundur për t’u realizuar, me vendim të arsyetuar, mund të procedohet me shqyrtimin e kërkesës pa u njoftuar më parë palët.....”.

16. Paraprakisht, ky Kolegj vlerëson të theksojë se për të njëjtën çështje objekt shqyrtimi është paraqitur kërkesë për pezullim në datë 26.12.2019 nga Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” dhe në datë 27.12.2019 nga Avokatura e Shtetit. Ky Kolegj, këto kërkesa i ka gjykuar dhe ka marrë vendimin nr. 162/529, 06.07.2020 dhe vendimin nr. 163/531, datë 06.07.2020, duke vendosur mospranimin e kërkesë për pezullim mbi bazën e argumentave të palëve kërkuese, të cilët nuk kanë paraqitur asnjë shkak ligjor konkret për të cilin kërkohet pezullimi. Në vijim ka rezultuar se pala kërkuese Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” ka paraqitur argumenta ligjor shtesë dhe për të cilat ky Kolegj çmon se ka vend të merren në shqyrtim dhe për të cilën do të arsyetohet si më poshtë.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, në dallim nga kërkesa e mëparshme është orientuar nga praktika e konsoliduar e Kolegjit Administrativ në lidhje me kushtet ligjore që kërkohen të plotësohen për pranimin e kërkesës për pezullim.

18. Për sa i përket shkaqeve për pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi, të parashtruar nga pala kërkuese në pjesën hyrëse të këtij vendimi, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, ka parashtruar dhe argumentuar qartësisht lidhur me rrethanat konkrete të një dëmi me pasojave të rënda dhe të pariparueshme, çka bënë që Gjykata e Lartë të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

19. Shkaku i pretenduar për rëndësinë që paraqet përdorimi i burimeve financiare të palës kërkuese në veçanti në situatën e krijuar nga pandemia e shkaktuar nga virusi COVID

19, duke marrë në konsideratë vlerën e shpërblimit të njohur nga gjykata, e cila do të cënonte rëndë interesin publik dhe që ndikon drejtpërsëdrejti në funksionimin normal dhe në mungesën e dhënies së shërbimit shëndetësor nga ana e palës kërkuese Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, përbën një shkak të mjaftueshëm për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

20. Në këtë kuadër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë thekson se për përballimin e situatës së pandemisë ka qenë e nevojshme angazhimi i të gjitha resurseve nga ana e institucioneve shëndetësore. Këtu bëhet fjalë jo vetëm për resurset njerëzore, por edhe ato infrastrukturore dhe financiare. Për më tepër, për kapërcimin e problematikave të shkaktuara nga pandemia e virusit COVID 19, është e nevojshme që të gjitha institucionet shëndetësore të funksionojnë normalisht dhe duhet të jenë në gadishmëri të plotë për marrjen e masave eventuale në përballimin e situatës dhe ofrimin e shërbimit shëndetësor. Kjo nënkupton faktin se është parësore mos vënia në rrezik e asnjë jete njerëzore si pasojë e mungesë së shërbimeve, medikamenteve apo ambienteve infrastrukturore të domosdoshme, prandaj është e nevojshme që buxheti i palës kërkuese, momentalisht, të mos bllokohet, duke vijuar punën deri në normalizimin e situatës si pasojë e pademisë COVID 19.

21. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet një kërkim dhe pretendim i mbështetur në ligj, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, duke parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

22. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, pasi ekzekutimit i tij, do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, të paraqitur nga Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

Tiranë, më datë 27.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 229 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

| | |
|----------------------|-----------------|
| Sokol SADUSHI | Kryesues |
| Ervin PUPE | Anëtar |
| Ilir PANDA | Anëtar |

Sot në Tiranë, më datë 27.07.2020, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me Nr. Akti 229/2020, që i përket:

KËRKUES: Avokatura e Shtetit.

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.35, datë 21.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Arben Sina.

E PADITUR: Agjencia e Trajtimit të Pronave.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit për vlerësimin financiar të palës së paditur, për kompensimin e tyre si trashëgimtarë të ish pronarit Sali (Salih) Sina.

2. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 35, datë 21.02.2020, ka vendosur:

“1. Pranimin e kërkesëpadisë.

2. *Ndryshimin e vlerësimit financiar të kryer nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për sipërfaqen 9050 m², trajtuar me vendimin nr. 689, datë 09.09.1996, të ish Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Tiranë.*

3. *Detyrimin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave të kompensojë financiarisht trashëgimtarët e ish-pronarit Sali (Salih) Sina, në shumën 115.488.250 (njëqind e pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.*

4. *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit Agjencia e Trajtimit të Pronave”.*

3. **Kundër vendimit nr. 35, datë 21.02.2020**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs Avokatura e Shtetit, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

4. **Avokatura e Shtetit** në datën 06.07.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë, së bashku me rekursin, një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 35, datë 21.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimi nr. 35, datë 21.02.2020, i Gjykatës Administrative të Apelit, është një vendim i marrë në interpretim të gabuar të ligjit nr. 133/2015.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit e ka vendosur palën e paditur në vështirësi të theksuara dhe nuk ka vend për zbatimin e parashikimeve të bëra në nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile, pasi kërkitimi nuk është abuziv e me keqdashje.*
- *Kërkitimi për pezullim të ekzekutimit të vendimit ka për qëllim parandalimin e kërkitimit për ekzekutim të vendimit, i cili sjell shkaktimin e një dëmi të konsiderueshëm nga ana e subjektit fitues me vendimin e rekursuar.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. *Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

a) *ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

11. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tij.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit është e pabazuar në ligj. Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullim, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, premisën e parë të bazueshmërisë në ligj ka objektin, që do të thotë vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret objekti i kërkesës nuk rezulton të jetë vendim gjyqësor i formës së prerë.

13. Së pari, neni 451, shkronja “ç”, i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se:

“Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:

...ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.”.

14. Në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit, sipas nenit 29 të Ligjit nr. 133/2015, e ka gjykuar çështjen si gjykatë e shkallës së parë, duke ushtruar juridiksionin fillestar.

15. Së dyti, sipas nenit 5 pika 17 e Ligjit nr. 133/2015 “Vendim përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet

e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtruar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë. Më tej, neni 30 i Ligjit nr. 133/2015 parashikon se:

“1. Kur vendimi i marrë, sipas këtij ligji, bëhet përfundimtar, Agjencia ose çdo palë e interesuar e dërgon atë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrim.

2. Për vendimet që nuk u është dhënë formë e prerë, për shkak të ndryshimeve të ligjit, Agjencia verifikon nëse është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe, në rast të kundërt, këto vendime konsiderohen të formës e prerë.”.

16. Kjo do të thotë se vendimi gjyqësor objekt rekursi në këtë rast nuk është i formës së prerë. Për rrjedhojë kërkesa nuk duhet të pranohet për gjykim. Përsëritja nga ana e kërkuarit e një kërkesë të tillë në të ardhmen do të përbëjë shkak ligjor për zbatimin e sanksionit procedural të parashikuar nga pika 1 e nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga Avokatura e Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 35, datë 21.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 27.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 232 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

| | |
|----------------------|-----------------|
| Sokol SADUSHI | Kryesues |
| Ervin PUPE | Anëtar |
| Ilir PANDA | Anëtar |

Sot në Tiranë, më datë **27.07.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me **Nr. Akti 232/2020**, që i përket:

KËRKUES: Agjencia e Trajtimit të Pronave.

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.24, datë 13.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Shefki Petrela, Arben Petrela, etj.

E PADITUR: Agjencia e Trajtimit të Pronave.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit për vlerësimin financiar të palës së paditur, për kompensimin e tyre si trashëgimtarë të ish pronarit Hatixhe Petrela.

2. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr.24, datë 13.02.2020, ka vendosur:

“1. Pranimin e kërkesëpadisë.

2. *Ndryshimin e vlerësimit financiar të kryer nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për sipërfaqen 8238 m², trajtuar me vendimin nr. 314, datë 02.11.1995, të ish Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Tiranë.*

3. *Detyrimin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave të kompensojë financiarisht trashëgimtarët e ish-pronares Hatixhe Petrela, në shumën 248.441.604 (dyqind e dyzet e tetë milion e katërqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e katër mijë) lekë.*

4. *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit Agjencia e Trajtimit të Pronave”.*

3. **Kundër vendimit nr. 24, datë 13.02.2020**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Agjencia e Trajtimit të Pronave, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

4. **Pala e paditur**, Agjencia e Trajtimit të Pronave, në datën 06.07.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë, së bashku me rekursin, një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 24, datë 13.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vlerësojmë se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në kundërshtim me ligjin material, si rrjedhojë e analizës jo të drejtë të provave dhe zbatimit jo korrekt të ligjit.*
- *Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit do të ngarkonte palën e paditur me një detyrim financiar kundrejt palës paditëse në kundërshtim me ligjin nr. 133/2015.*
- *Për sa kohë që në ligjin e posaçëm nr. 133/2015 është parashikuar në mënyrë laksative që një vendim bëhet përfundimtar kur të ketë përfunduar shqyrtimi në gjykatat e të gjitha niveleve, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, atëherë nuk mund të ngarkohet pala e paditur me një detyrim në kundërshtim me këto parashikime ligjore.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

11. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tij.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit është e pabazuar në ligj. Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullim, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, premisën e parë të bazueshmërisë në ligj ka objektin, që do të thotë vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret objekti i kërkesës nuk rezulton të jetë vendim gjyqësor i formës së prerë.

13. Së pari, neni 451, shkronja “ç”, i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se:

“Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:

...ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.”.

14. Në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit, sipas nenit 29 të Ligjit nr. 133/2015, e ka gjykuar çështjen si gjykatë e shkallës së parë, duke ushtruar juridiksion fillestar.

15. Së dyti, sipas nenit 5 pika 17 e Ligjit nr. 133/2015 “Vendim përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtuar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë. Më tej, neni 30 i Ligjit nr. 133/2015 parashikon se:

“1. Kur vendimi i marrë, sipas këtij ligji, bëhet përfundimtar, Agjencia ose çdo palë e interesuar e dërgon atë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrim.

2. Për vendimet që nuk u është dhënë formë e prerë, për shkak të ndryshimeve të ligjit, Agjencia verifikon nëse është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe, në rast të kundërt, këto vendime konsiderohen të formës e prerë.”.

16. Kjo do të thotë se vendimi gjyqësor objekt rekursi në këtë rast nuk është i formës së prerë. Për rrjedhojë kërkesa nuk duhet të pranohet për gjykim. Përsëritja nga ana e kërkuarit e një kërkesë të tillë në të ardhmen do të përbëjë shkak ligjor për zbatimin e sanksionit procedural të parashikuar nga pika 1 e nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Agjencia e Trajtimit të Pronave, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 24, datë 13.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 27.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 231 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

| | |
|----------------------|-----------------|
| Sokol SADUSHI | Kryesues |
| Ervin PUPE | Anëtar |
| Ilir PANDA | Anëtar |

Sot në Tiranë, më datë 27.07.2020, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me Nr. Akti 231/2020, që i përket:

KËRKUES: Avokatura e Shtetit.

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 24, datë 13.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Shefki Petrela, Arben Petrela, etj.

E PADITUR: Agjencia e Trajtimit të Pronave.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit për vlerësimin financiar të palës së paditur, për kompensimin e tyre si trashëgimtarë të ish pronarit Hatixhe Petrela.

2. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 24, datë 13.02.2020, ka vendosur:

“1. Pranimin e kërkesëpadisë.

2. *Ndryshimin e vlerësimit financiar të kryer nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për sipërfaqen 8238 m², trajtuar me vendimin nr. 314, datë 02.11.1995, të ish Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Tiranë.*

3. *Detyrimin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave të kompensojë financiarisht trashëgimtarët e ish-pronares Hatixhe Petrela, në shumën 248.441.604 (dyqind e dyzet e tetë milion e katërqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e katër mijë) lekë.*

4. *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit Agjencia e Trajtimit të Pronave”.*

3. **Kundër vendimit nr. 24, datë 13.02.2020**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs Avokatura e Shtetit, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

4. **Avokatura e Shtetit** në datën 06.07.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë, së bashku me rekursin, një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 24, datë 13.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimi nr. 24, datë 13.02.2020, i Gjykatës Administrative të Apelit, është një vendim i marrë në interpretim të gabuar të ligjit nr. 133/2015.*
- *Në kushtet kur konflikti i pretenduar është zgjidhur me vendim të formës së prerë dhe ekzekutimi i vendimit ndaj të cilit po ushtrohet rekurs do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. *Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

a) *ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

b) *pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe

gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

11. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tij.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit është e pabazuar në ligj. Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullim, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, premisë e parë të bazueshmërisë në ligj ka objektin, që do të thotë vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret objekti i kërkesës nuk rezulton të jetë vendim gjyqësor i formës së prerë.

13. Së pari, neni 451, shkronja “ç”, i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se:

“Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:

...ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.”.

14. Në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit, sipas nenit 29 të Ligjit nr. 133/2015, e ka gjykuar çështjen si gjykatë e shkallës së parë, duke ushtruar juridiksion fillestar.

15. Së dyti, sipas nenit 5 pika 17 e Ligjit nr. 133/2015 *“Vendim përfundimtar”* është çdo vendim administrativ ose gjyqësor i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtruar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë. Më tej, neni 30 i Ligjit nr. 133/2015 parashikon se:

“1. Kur vendimi i marrë, sipas këtij ligji, bëhet përfundimtar, Agjencia ose çdo palë e interesuar e dërgon atë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrim.

2. Për vendimet që nuk u është dhënë formë e prerë, për shkak të ndryshimeve të ligjit, Agjencia verifikon nëse është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe, në rast të kundërt, këto vendime konsiderohen të formës e prerë.”.

16. Kjo do të thotë se vendimi gjyqësor objekt rekursi në këtë rast nuk është i formës së prerë. Për rrjedhojë kërkesa nuk duhet të pranohet për gjykim. Përsëritja nga ana e kërkuarit e një kërkesë të tillë në të ardhmen do të përbëjë shkak ligjor për zbatimin e sanksionit procedural të parashikuar nga pika 1 e nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga Avokatura e Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 24, datë 13.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 27.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 228 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Sot më datë 27.07.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 228 Regjistri, datë 06.07.2020, si më poshtë:

Kërkues: Agjencia e Trajtimit të Pronave

Objekti: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr.228, datë 22.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Baza ligjore: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: Z. Flamur Hysejani
Znj. Adriana Coho
Z. Afrim Hysejani
Z. Agron Hysejani
Z. Arbër Xhameta
Z. Artur Hysejani
Z. Bajram Xhameta
Z. Dhimitër Tabaku
Z. Elton Bejleri
Z. Enrieta Muçollari
Z. Fatimir Libohova
Znj. Feleke Hysejani
Znj. Feze Libohova
Z. Ilir Hysejani
Znj. Liliana Libohova
Znj. Majlinda Kapaj
Znj. Miranda Vokshi
Znj. Myhyrije Hysejani
Znj. Naime Hysejani

Znj. Nevila Bejleri
Znj. Silvana Canaj
Z. Sokol Hysejani
Znj. Suela Bejleri
Znj. Xheni Hysejani
Znj. Xhulja Hysejani
Znj. Zenepe Hysejani

I paditur: **Agjencia e Trajtimit të Pronave**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Në këtë çështje ka për gjykim një kërkesë për pezullim të paraqitur së bashku me rekursin e palës kërkuese dhe rekursuese.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 228, datë 22.10.2019** ka vendosur:

“- *Pranimin e kërkesëpadisë;*

– *Ndryshimin e vendimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave për vlerësimin financiar kryer për Vendimin nr. 40 datë 16.01.1997 të ish-KKKP të Këshillit të Rrethit Tiranë që i përket ish pronarëve Selim Libohova dhe Qenam Libohova, nga 1.065.626 lekë, në 2.677.404 (dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) lekë;*

- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur; - Ky vendim përbën titull ekzekutiv;*

- *E drejta e rekursit kundër këtij vendimi mund të ushtrohet në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të tij palëve ndërgjyqëse.”*

3. Pala e paditur ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor dhe duke kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim. Bashkë me rekursin është paraqitur edhe kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

4. **Në aktin e rekursit pala e paditur, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë**, por nuk ka parashtruar asnjë argument mbështetës lidhur me këtë kërkim. Në kërkesë është parashtruar se:

- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është dhënë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural;*

- *Gjykata Administrative e Apelit ka shkelur nenet 6 e vjues te Ligjit nr. 133/2015 dhe VKM nr. 222 datë 23.03.2016 lidhur me metodologjinë e vlerësimit dhe përlllogartjen e vlerës së pronës së ish pronarëve;*

- *Përlllogaritja e vlerës totale për kompensim është 1.065.625,95 lekë.*

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur që të procedohet me noftimin e palëve sipas nenit 479/2 të Kodit të Procedurës Civile mbi kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Koncretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për

pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit është e pabazuar në ligj. Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullim, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, premisën e parë të bazueshmërisë në ligj ka objektin, që do të thotë vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret objekti i kërkesës nuk rezulton të jetë vendim gjyqësor i formës së prerë.

14. **Së pari**, sipas nenit 451 shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Civile parashikon se:
*“Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:
...ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.”.*

15. Në rastin konkret Gjykata Administrative e Apelit, sipas nenit 29 të Ligjit nr. 133/2015, e ka gjykuar çështjen si gjykatë e shkallës së parë, duke ushtruar juridiksionin fillestar.

16. **Së dyti**, sipas nenit 5 pika 17 e Ligjit nr. 133/2015 “Vendim përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtuar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë. Më tej neni 30 i Ligjit nr. 133/2015 parashikon se:

“1. Kur vendimi i marrë, sipas këtij ligji, bëhet përfundimtar, Agjencia ose çdo palë e interesuar e dërgon atë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrim.

2. Për vendimet që nuk u është dhënë formë e prerë, për shkak të ndryshimeve të ligjit, Agjencia verifikon nëse është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe, në rast të kundërt, këto vendime konsiderohen të formës e prerë.”.

17. Kjo do të thotë se vendimi gjyqësor objekt rekursi në këtë rast nuk është i formës së prerë. Për rrjedhojë kërkesa nuk duhet të pranohet për gjykim. Përsëritja nga ana e

kërkuesit e një kërkese të tillë në të ardhmen do të përbëjë shkak ligjor për zbatimin e sanksionit procedural të parashikuar nga pika 1 e nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

*Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012
“Për gjykimin administrativ dhe gjykatat administrative dhe Nenin 479 të Kodit të
Procedurës Civile;*

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Agjencisë së Trajtimit të Pronave për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 228, datë 22.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 27.07.2020

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 234 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

| | |
|----------------------|-----------------|
| Sokol SADUSHI | Kryesues |
| Ervin PUPE | Anëtar |
| Ilir PANDA | Anëtar |

Sot në Tiranë, më datë **27.07.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me **Nr. Akti 234/2020**, që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “**SBM ENERGJI**” sh.p.k.

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 4554, datë 22.11.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 352, datë 17.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Shoqëria “**SBM ENERGJI**” sh.p.k.

TË PADITUR: 1. **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.**
2. **Shoqëria “Mati Hydropower” sh.p.k.**

PERSON I TRETË Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur për të zbatuar kontratën e koncesionit si dhe deklarimin e pavlefshmërisë së shtesës së kontratës së koncesionit.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 4554, datë 22.11.2017, ka vendosur:

“1. Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse”.

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 352, datë 17.02.2020, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 4554, datë 22.11.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

4. **Kundër vendimit nr. 352, datë 17.02.2020**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala paditëse, Shoqëria “SBM ENERGI” sh.p.k., e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 4554, datë 22.11.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe pranimin e padisë.

5. **Pala paditëse**, Shoqëria “SBM ENERGI” sh.p.k., në datën 07.07.2020, së bashku me rekursin, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4554, datë 22.11.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 352, datë 17.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit si dhe nuk pajtohen me provat e administruara gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë, të cilat ndodhen në dosje.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i këtyre vendimeve haptazi në kundërshtim me ligjin i sjell pasoja të rënda dhe të pariparueshme palës paditëse, Shoqërisë “SBM ENERGI” sh.p.k.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala paditëse është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

15. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

16. Ky Kolegj, vlerëson të theksojë qëndrimin e Gjykatës së Lartë, e cila çon automatikisht në rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj, se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit, vendoset kur kemi të bëjmë me vendime gjyqësore që mbartin detyrime për palët dhe në rastin konkret jemi para rastit kur padia është rrëzuar nga ana e gjykatës dhe nuk ka ngarkuar me detyrime asnjë nga palët ndërgjyqëse.

17. Kolegji Administrativ sjell në vëmendje se si rregull i përgjithshëm vendimet e rrëzimit të padisë nuk mund të përbëjnë tituj ekzekutiv sipas nenit 510 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile dhe se për rrjedhojë përjashtohet apriori mundësia që ato të ekzekutohen dhe të sjellin rrezik apo pasoja të parikuperueshme në të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshëm të palës rekursuese dhe njëkohësisht kërkuese. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor që ka rrëzuar padinë, jo vetëm që nuk ka lidhje me interesin e kërkuesit, por as nuk shmang ndonjë dëm për kërkuesin.

18. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pala kërkuese nuk mund të ushtrojë këtë lloj kërkimi pranë Gjykatës së Lartë, pasi sigurimi i padisë dhe pezullimi i ekzekutimit të vendimit, parashikuar nga nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, janë dy koncepte të ndryshme dhe që u përkasin shkallëve të ndryshme. Pra, paditësi konfondon haptazi kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor që ka rrëzuar padinë e tij, me atë të pezullimit të aktit administrativ.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala paditëse, Shoqëria “SBM ENERGJI” sh.p.k., për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4554, datë 22.11.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 352, datë 17.02.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 27.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI